“Allahumme leke eslemtu, ve bike amentu, ve alejke tevekkeltu, ve ilejke enebtu, ve bike hasamtu, Allahumme inni eudhu bi izzetike, la ilahe il-la Ente en tuddileni, Entel hajju el-ledhi la jemut, vel xhinu vel insu jemutune", - O Allah, Ty të jam dorëzuar, Ty të kam besuar, në Ty jam mbështetur, te Ti pendohem dhe për Ty armiqësohem! O Allah, kërkoj mbrojtje përmes krenarisë Sate, - nuk ka të adhuruar të denjë përveç Teje, - të më ruash nga devijimi! Ti je i Gjalli që nuk vdes, ndërsa xhinët dhe njerëzit vdesin!”

Ibn Abasi (Allahu qoftë i kënaqur me të!) transmeton se i Dërguari i Allahut lutej kështu: “Allahumme leke eslemtu, ve bike amentu, ve alejke tevekkeltu, ve ilejke enebtu, ve bike hasamtu, Allahumme inni eudhu bi izzetike, la ilahe il-la Ente en tuddileni, Entel hajju el-ledhi la jemut, vel xhinu vel insu jemutune", - O Allah, Ty të jam dorëzuar, Ty të kam besuar, në Ty jam mbështetur, te Ti pendohem dhe për Ty armiqësohem! O Allah, kërkoj mbrojtje përmes krenarisë Sate, - nuk ka të adhuruar të denjë përveç Teje, - të më ruash nga devijimi! Ti je i Gjalli që nuk vdes, ndërsa xhinët dhe njerëzit vdesin!”

[Sahih] [متفق عليه، وهذا لفظ مسلم ورواه البخاري مختصرًا]

Profeti lutej: "O Allah, Ty të jam dorëzuar, dhe nënshtruar, Ty të kam besuar plotësisht dhe të kam pranuar. Në Ty jam mbështetur dhe e kam lënë çështjen time. Te Ti pendohem dhe kthehem, dhe për Ty armiqësohem me armiqtë e Tu! O Allah, kërkoj mbrojtje dhe mbështetje përmes Krenarisë Sate dhe mbrojtjes dhe Epërsisë Sate. Nuk ka të adhuruar të denjë përveç Teje! Vetëm Ti e meriton adhurimin. Të më ruash nga devijimi nga udhëzimi dhe përkrahja (suksesi) për ta arritur kënaqësinë Tënde.Ti je i Gjalli që nuk vdes e nuk shuhet, ndërsa xhinët dhe njerëzit vdesin!”